



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.20, datë 01/08/2023

PËR

**MIRATIMIN E “KËRKESË PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË
LEJES” HEC “RRËSHEN” TË SHOQËRISË “NIKOLLI ENERGY”
SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike me Nr.serie 00085, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.5, datë 22.12.2017 HEC “Rrëshen”, subjektit “Nikolli Energy” sh.p.k., me vendndodhje, përroi i Rrëshenit, degë e lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

HEC "RRËSHEN"

Vepra e marrjes, përroi Rrëshen

- $X=489797.6$
- $Y=4619701.6$
- $Z=223$ m.m.n.d
- $Q_{mes}=0.26$ m³/s
- $Q_{llog}=0.48$ m³/s
- $Q_{eko}=0.03$ m³/s

Godina e Centralit

Pika e shkarkimit

- $X=486915.5$
- $Y=4616369$
- $Z=160$ m.m.n.d

- Fuqia max e instaluar $N=250$ kW
- Energjia Vjetore $E=890,362$ kWh/vit.

3. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë prodhimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës, plotësimin e nevojave për ujitje, sipas kërkesave të organeve të vetëqeverisjes vendore, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

